

*Rizah Sheqiri  
Shefkije Islamaj  
Xhevat Syla*

Për nivelin  
e parë

## *LETĒRSI SHQIPTARE*



EMRI DHE MBIEMRI:

KLASA

SHKOLLA

VENDI

SHTETI

*dukgjini*

ISBN 978-9951-05-236-4



39004891290206

Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Syla

# LETËRSI SHQIPTARE

(Lexime)

Fletore tematike  
për nivelin e parë

**duk<sup>ə</sup>gjini**

# **MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS**

## **TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË**

Autorë/e:

Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti-Metis, Nexhat Maloku, Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevati Syla.

Hartues të këtij teksti: Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevati Syla

Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut (Instituti IPE -International Projects in Education) dhe Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.

**PH Zürich**



**LOTTERIEFONDS  
KANTON ZÜRICH**

## PËRMBAJTJA

I dashur Atdhe (Asdreni).....	5
Nina, nëna, o mor bir.....	6
Plotësojmë vargjet .....	7
Stinët e motit .....	8
Bora e parë.....	10
Shqiponja (Xh. Spahiu; K. Kristoforidhi).....	11
Kush e qethi pyllin (Odhise Grillo).....	13
Ujku dhe luani (Ezopi).....	14
Gëzuar ditëlindjen (Xhevät Beqaraj).....	15
Gjëegjëza.....	18
Mbollën të tjerët, ha ti-mbill ti, të hanë të tjerët (Sami Frashëri).....	19
Kori gazmor (Ramadan Pasmaçiu).....	20
Aroma e detit (Hajro Ulqinaku).....	22
Tre diejt e Dianës (Rrahman Dedaj).....	24
Lepuroshi (Rexhep Hoxha).....	26
Blega, dega dhe shega (Arif Demolli).....	28
Viti i Ri (Agim Deva).....	30
Mbreti dhe buburreci (Përrallëz shqiptare).....	32
Shkolla ime (Mehmedali Hoxha).....	35
Fustani i Zanës (Shkëlzen Zalli).....	36
Çupa që derdhëtë trëndafila nga goja (Përrallë shqiptare).....	37
Festa jote – festa ime (Adelina Mamaqi).....	39
Gomari dhe ujku (Bedri Dedja).....	40
Erdh' babi nga kurbeti (Gaço Bushaka).....	42
Guri i Skënderbeut (Naum Prifti).....	44
Zogu cicëron (Arif Demolli).....	46
Mungesa në mësim (Arian Krasniqi).....	48
Pemët në verë (Vehbi Kikaj).....	50
Dy dhitë (Konstantin Kristoforidhi).....	52
Shkopi magjik (Rifat Kukaj).....	54
Zemra e diellit (Ymer Elshani).....	56
Vendi im i shtrenjtë (Hivzi Sulejmani).....	58



## I DASHUR ATDHE!...

Me vite jam larguar,  
i dashur Atdhe,  
po nuk të kam harruar,  
se shumë i ëmbël je.

Të fala të dërgoj,  
Këndeje ku jam, Atdhe,  
Gjithnjë po të kujtoj,  
Se birin tënd më ke!

ASDRENI

### Bisedojmë për vjershën

Si dhe ku e përjeton atë që i këndon atdheut në këtë poezi?  
Edhe ti jeton larg atdheut të prindërve të tu.  
Cili është atdheu i prindërve të tu?  
Ç'ndjenja ke ndaj atij atdheu?  
Si e përshëndet poeti atdheun e vet nga mërgimi?

### Mësojmë më shumë

Këtë poezi e bëjnë muzikale posaçërisht fjalët në fund të vargjeve, si *larguar, harruar, apo Atdhe, je.* Përputhshmëria e këtillë tingullore e vargjeve quhet *rimë*.

### Detyrë:


Shkruaj tri fjali për ndjenjat që ke ndaj atdheut dhe tri fjali për ndjenjat e tua ndaj vendit ku jeton tash!

## NINA, NINA, O MOR BIR

Nina, nina, o mor bir,  
Fli se gjumi të bën mirë;  
Nëna po të mban në gji,  
Fli, o shpirti i nënës, fli!

Nëna dorën nuk ta ndan,  
fli se nëna të ka xhan;  
nina, nina, o mor bir,  
fli se gjumi të bën mirë!

*Këngë djepi*



*Fjalorth*  
*xhan - shpirt*

### Bisedojmë për këngën

Këtë këngë nëna ia këndon fëmijës së saj foshnjë. Këto këngë quhen edhe *ninulla*. Ato këndohen me dashuri të madhe.

Në këtë këngë djepi janë përdorur tri fjalë, në të cilat gjenden shkronjat *gj* dhe *xh*. Gjej ato fjalë dhe shqiptoji drejt!

### Detyrë:

Pyet prindërit e tu nëse dinë ndonjë ninullë.  
Nëse dinë, shkruaje një sosh në fletore.

## PLOTËSOJMJË VARGJET

Plaku ecën me shkop.  
Futboll a luhet pa \_\_\_\_\_?

Mitrovicën e përshkon lumi Ibër.  
Mësim a mund të bëhet pa \_\_\_\_\_?

Yjet që shndrisin qiellit,  
N'agim i dorëzohen \_\_\_\_\_.

Më tha një ditë nëna:  
-Ti më bën dritë si \_\_\_\_\_.

Kënaqem kur dal në natyrë,  
Në shkollë kryej çdo \_\_\_\_\_.

Kënaqësi i fal shkolla  
Lulit me faqet si \_\_\_\_\_.

Më e madhja dashuri  
Nëna është për çdo \_\_\_\_\_.

### Bisedojmë për vargjet

Nga vargjet e shkruara më sipër shohim si krijohet rima. Rima i jep muzikalitet vjershës. Ajo na ndihmon ta mësojmë më lehtë atë.

### Detyrë:

Formoni dy shtylla dhe pranë e pranë shënoni fjalë që rimohen (si mur - gur, sot - mot etj.).

Provoni të krijoni vargje që rimojnë!



## STINËT E MOTIT

### 1. A,a,a,a,a,a,a!

Eni këndoni,  
K'ceni e gëzoni!  
A,a,a,a,a,a!

### 2. E,e,e,e,e,e,e!

Eni si era,  
Se erdh' pranvera!  
E,e,e,e,e,e!

### 3. I, i, i, i, i, i, i, i!

Eni e ngasim,  
T'k'cejmë e t'bërtasim:  
I, i, i, i, i, i, i, i!

### 4. O,o,o,o,o,o,o,o!

Ngani një hera,  
Se tash erdh' vera!  
O,o,o,o,o,o,o!

### 5. U,u,u,u,u,u,u,u!

Ngani ndër vreshta,  
Se qe erdh' vjeshta!  
U,u,u,u,u,u,u!

### 6. Y,y,y,y,y,y,y,y!

Dimri mbërrini!  
Ru'nju t'mos ngrini!  
Y,y,y,y,y,y,y!

## *Fjalorth*

k'ceni – kërceni  
k'cejmë - kércejmë  
ru'nju - ruajuni

### **Bisedojmë pér këngën**

Diskutoni pér **zanoret** dhe **bashkëtingëlloret** e alfabetit të gjuhës shqipe.  
Gjeje cila zanore nuk përdoret në këtë këngë!

Krahasoni zanoret e gjuhës shqipe me zanoret e gjuhës së vendit ku jetoni!

### **Këndoymë:**

popullore gjermane

3/4

A. a. A. a A. a. a. a ka - tär vall - ta - re

pér - her né va - lle A. a. A. a. a. A. a. a. a.

## BORA E PARË

Ra  e parë. Fëmijët, të gëzuar,

dolën në  . Ata ndërtuan një



Fëmijët u kapën në



rreth tij. Bashkë me ta në

valle u kap edhe  i vogël. Qenit ia kishin lidhur

një shall rreth qafe. Edhe fëmijët kishin vënë  në kokë.

Sa bukur dukeshin fëmijët në bardhësinë e borës!

### Bisedojmë

A ju pëlqen natyra kur bie borë dhe pse?

Cilat sporte luhen në borë?

Përshkruaje një ditë pushimi gjatë stinës së dimrit.

### Detyrë:

Shkruani këtë rrëfim në fletore, duke shkruar në vend të figurave fjalët.

## SHQIPONJA

Hape krahët, fluturove  
Thellë në kaltërsi.

Udhëtove, udhëtove,  
Çerdhen ku do ta bësh ti?

Ty asgjë s'ta mbushka syrin?  
As kjo pemë? As ky gur?

Më në fund, moj trimërore,  
Bëre çerdhe në flamur.


Xhevahir SPAHIU



## Mësojmë më shumë për shqiponjën Shqiponja

Shqiponja është më e fortë se të gjithë zogjtë që fluturojnë në qiell. Këta zogj trima dhe të fortë ndahen në shumë lloje dhe kanë shumë emra. Disa prej tyre quhen skifterë, disa quhen shqipe, shqiponja ose petritë.

Shqiponja e ka sqepin të kthyer porsi grep dhe thonjtë porsi shtiza të mprehta. Shqiponja ha zogj të gjallë, lepuj, breshka dhe hardhuca. Asnjë nga zogjtë nuk i del kundër shqiponjës. Ajo është përmbi të gjithë shpendët e qiellit, ashtu si edhe luani përmbi të gjitha shtazët e tokës, prandaj quhet mbreti i shpendëve. Shqiponjat i ndërtojnë foletë e tyre nëpër male të larta, nëpër shkrepë dhe shkëmbinj.



Konstantin KRISTOFORIDHI

### Bisedojmë për vjershën

Me këtë vjershë të bukur poeti na mëson si u vendos shqiponja në flamurin tonë kombëtar. Ky fluturim i shqiponjës ka ndodhur shumë moti, ndaj edhe flamuri ynë kombëtar është ndër më të vjetrit në botë. Ka dy ngjyra: kuq e zi. Me këtë flamur ka luftuar edhe Skënderbeu për çlirimin e atdheut. Flamuri vihet për të valuar në ditë festash. Dita e flamurit tonë kombëtar është 28 Nëntori. Pse? Përgjigjuni bashkë me mësuesin/sen.

### Detyrë:

Cili është më i forti nga të gjithë zogjtë që fluturojnë në qiell?

Si e ka sqepin dhe si i ka thonjtë shqiponja?

Çfarë ha shqiponja?

Si quhet ndryshe shqiponja dhe pse?

Ku i ndërtojnë çerdhet shqiponjat?

A të duket shqiponja zogu më i dashur dhe pse?

Vizatojeni flamurin tonë kombëtar dhe ngjyroseni atë.



## KUSH E QETHI PYLLIN?

Babadimri në mal doli,  
shi e borë kudo hodhi...

Më pastaj në pyll u ndal  
edhe tha: - O pyll, më fal,  
po i ke ca gjethe tepër,  
duhen qethur sot, patjetër!

Mjekërbardhi kësaj here  
thirri erën si berbere...

Era erdhi me gërvshërë,  
qethi pyllin që të tërë!

E kështu, veç për një çast,  
Mbeti pylli krejt... tullac!



Odhise GRILLO

### *Fjalorth*

**berbere** – flokëtare  
**që të tërë** – të terin, krejt  
**tullac** – njeri pa flokë

### **Bisedojmë për poezinë**

Në këtë poezi kemi një pamje dimri, e cila na jepet aq e gjallë nëpërmjet shpirtëzimit të babadimrit dhe erës.

Në këtë poezi Babadimri quhet edhe ndryshe, si?

### **Mësojmë më shumë**

Kjo poezi është e shkruar në dyvargësh, por shumica e poezive shkruhen me katërvargësh etj.

### **Detyrë**

Thoni emrat e disa drurëve që rriten në vendin ku jetoni.  
Mësojeni përmendsh këtë poezi.

## UJKU DHE LUANI


Njëherë një ujk bartte në krah një dele, të cilën e kishte rrëmbyer në vathë. Rrugës e takoi luani dhe ia mori. Ujku u ndal pak më larg e tha:

- Me të padrejtë ma ke rrëmbyer.

Luani qeshi e i tha:

- Pse, a mos e more ti prej mikut në mënyrë të ndershme?

EZOPI



*Fjalorth*

vathë – vend ku rri bagëtia

### Bisedojmë për përrallëzën

Pse ia rrëmbeu luani delen ujkut?

Çka i tha ujku luanit?

Po luani çka i tha ujkut?

Cili kishte më shumë të drejtë?

Në këtë përrallëz thumbohen grabitqarët dhe grykësit, meqë kanë të njëjtin ves. Prandaj ata kot e shajnë njëri-tjetrin.

### Mësojmë më shumë

Përrallëza është një rrëfim i shkurtër pér kafshët.

### Detyrë

Ritregoje në fletore këtë përrallëz.

## GËZUAR DITËLINDJEN

Vogëlushja jonë Elonë,  
Ditëlindjen sot feston.  
Vijnë shokët, shoqet vijnë,  
Mbushin plot me gaz shtëpinë.  
Në një gojë gjithë thonë:  
“Njëqind vjeç u bëfsh, Elonë!”

Sot dhe lulja e shqiponjës  
Duket se i thotë Elonës:  
“Çfarë kërkon të të dhuroj?...  
Ja një gjethë po e shtoj.  
Si na shtohet neve blerimi,  
Ty, Elonë, t'u shtoftë gëzimi!”

Xhevat BEQARAJ



### **Bisedojmë për vjershën**

Kush e feston ditëlindjen?

Si ia urojnë asaj ditëlindjen shoqet dhe shokët?

Çfarë duket se i thotë asaj luleshqiponja?

### **Detyrë**

Shkruani në fletore cilat urime i përdorim:

për ditëlindje: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

për përshëndetje: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

kur sëmuremi: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_


kur nisemi për në rrugë: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Kur e ke ti ditëlindjen? \_\_\_\_\_

Sa vjet do t'i mbushësh? \_\_\_\_\_

Çka dëshiron më së shumti të të dhurojnë për ditëlindje? \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Vizato dhuratën tënde të ëndërruar!



**Këndojmë:**

Thoni emrat e disa drurëve që rriten në vendin ku jetoni.  
Mësojeni përmendsh këtë poezi.

Sheet music for a happy birthday song. The lyrics are:

Ha - ppy birth - day to you  
Shumë u - ri - me pér ty

Ha - ppy birth - day to you  
Shumë u - ri - me pér ty

Ha - ppy  
Shumë u -

birth - day dear La - bi, ha - ppy birth - day to you  
ri - me ty La - bi, shumë u - ri - me pér ty

## GJËEGJËZA



Rrumbullak, strumbullak,  
Ka shtatë vrima rreth e qark.



Shumë këmbë ka.  
Por asgjë nuk ha.



Një patë qafëgjatë  
duke ikur bën shamatë.



Flet me ty, por nuk ka zë.  
E do fort e rri me të.



Kudo vete,  
Shtëpinë me vete



Janë pesë vëllezër  
njitur në themel,  
punojnë të pestë  
vetëm me një bel,  
askush nuk ua del.



Të mos jenë  
ato të tria,  
qumësht, kos  
nuk ka shtëpia.  
Një bën "mu"  
tjetra "me"  
dhe e treta  
"be-be-be".  
Cilat janë  
A i njeh?



### Detyrë

Lidh me shigjetë gjëegjëzën me ilustrimin përkatës.

### Zgidhjet e gjëegjëzave:

*libri, krehri, koka, breshka, aeroplani, breshka, gishtat e dorës,  
si dhe lopa delja dhe dhia*

## MBOLLËN TË TJERËT, HA TI-MBILL TI, TË HANË TË TJERËT

Një plak nëntëdhjetëvjeçar po mbillte një rrënë ulliri. Një mbret që shkonte aty pranë, u çudit nga kjo punë dhe e pyeti plakun:

- Kur mendon të të japë pemë ky dru që po mbjell?
- Pas tridhjetë vjetësh, – i tha plaku.
- Po mos vallë ke shpresë të rrosh dhe tridhjetë vjet që të hash pemë nga ky? – i tha mbreti.
- Jo, - u përgjigj plaku, – po mbollën të tjerët, hëngra unë; tash mbjell unë, të hanë të tjerët.



### Bisedojmë për përrallëzën

Në këtë përrallëz jepet një mësim i cili na nevojitet në jetë. Cili është ai mësim?

### Detyrë

Ndajini rolet dhe luajeni këtë tekst si një pjesë të shkurtër teatrale.

## KORI GAZMOR

Lart e poshtë  
në oborr  
po këndon  
një kor gazmor.


Ia bën pata:  
ga-ga-ga,  
pula e kuqe:  
ka-ka-ka;  
gjeli bën:  
ki-ki-ki,  
zogu i vogël:  
ci-ci-ci!

Ky është kori  
ynë gazmor,  
që jep shfaqje  
në oborr.

Ramadan PASMAÇIU



Muslim Mulliqi:  
*Afrodita*



## *Fjalorth*

kor - grup këngëtarësh që këndojnë së bashku.

### **Bisedojmë për vjershën**

Shkrimtari e quan këtë kor gazmor. Pse? Çka e bën atë të tillë? Nga kjo vjershë mësojmë se çfarë tingulli nxjerrin pata, pula, gjeli e zogu kur këndojnë.

### **Detyrë**

Shënoni në fletore tingujt që nxjerrin disa kafshë, si

*geni* \_\_\_\_\_  
*macja* \_\_\_\_\_  
*lopa* \_\_\_\_\_  
*derri* \_\_\_\_\_  
*qengji* \_\_\_\_\_  
*viçi* \_\_\_\_\_  
*kali* \_\_\_\_\_

### **Këndojmë: Kori gazmor**

**Allegro**

Lart e posht' në o-borr po kën-don një kor ga-zmor. Pa-ta bën ga-ga-ga

pu-la e ku-que kua-kua-kua. Ky eshtë' ko-ri yn' ga-zmor,

që jep shfa-qje te ne në o-borr. te ne në o-borr.

B. Shehu  
R. Pasmaçiu



## AROMA E DETIT

Aromën e detit duhet ndier.

E ndien atëherë kur: në mëngjes herët shëtit bregut të detit, ranishtës, zallinës, ose: në mbrëmje rri në majë të një shkëmbit, ndërsa valëzat i lajnë e i shpërlajnë algat e gocat e shtruara nëpër rrasha...

Atëherë do ta shijosh erën e detit.

Ajo vjen: nga erërat e detit, nga uji i detit, nga kripa, nga jodi, nga algat, guacat e peshqit, që valët i qesin në breg...

Vjen një puhi e pishave, e vreshtave, e ullishtave...

Është erë e barishteve mjekuese.

Ti e thith atë erë...

Është aromë e detit.

Kraharori të mbushet, si vel i barkës.

Do të jesh i shëndoshë – si ujk i detit.

Hajro ULQINAKU

### *Fjalorth*

**si ujk i detit** – këtu: detar, peshkatar i mocëm, i rrahur nga deti dhe erërat

### Bisedojmë për tekstin

Në cilin det keni qenë për pushime dhe në cilin vend? Sa ju ka pëlqyer ai vend?

Në këtë tekst autor i jep përshkrimin e aromës së detit. Kur ndihet ajo aromë, sipas autorit të këtij teksti? Nga vjen ajo aromë dhe cili është ndikimi i saj në ne?

### Mësojmë më shumë

Teksti që e lexuam nuk është as poezi, as tregim. Është një përshkrim i detit, një ndjenjë, një përjetim. Tekstet e këtilla në prozë që i ngjajnë poezisë quhen *proza poetike*.

### Detyrë

Përshkruani në fletore dobinë e pushimit në det për shëndetin tuaj.



## TRE DIEJT E DIANËS

Një ditë Diana mori tri fletë dhe vizatoi tre rrathë.  
Mori brushën dhe i ngjyrosi me ngjyrë ari.  
Atëherë e pa Mrika, motra e saj më e madhe:  
- Çka ke vizatuar kështu? – i tha buzagaz.  
- Tre diej të bukur, - u përgjigj Diana.  
- Diej! – sikur u habit Mrika.  
- Secili prej tyre do të lëshojë rreze të arta, - shtoi Diana.  
- Kujt i duhen këta diej, derisa e kemi diellin e madh? – foli motra.  
- Ja, - shpjegoi Diana, - dielli në fletën e parë është për gjyshin e sëmurë.  
Dielli i dytë është i dajës tim që ka shkuar larg në botë, ku bën shumë  
ftohtë. Ndërsa dielli i tretë do të rrezojë në dhomën tonë, kur dielli i madh  
të ikë pas bjeshkës së lartë dhe të fillojë muzgu.

Rrahman DEDAJ

*Fjalorth*  
**muzg** – terr i parë, jo shumë i errët

### Bisedojmë për tregimin

Tregimin e lindin dëshirat aq fisnike të vogëlushes Dianë. Ajo është e brengosur për të dashurit e vet, gjyshin dhe dajën, por edhe për njerëzit e tjera të familjes. Për të gjithë dëshiron të krijojë nga një diell.

### Pyetje

Ke dëshirë që edhe ti t'i bësh dhuratë ndokujt një vizatim te bukur?

Shkruaj çka do të vizatosh dhe për kë!

Për \_\_\_\_\_

---

---

Për \_\_\_\_\_

---

---

Për \_\_\_\_\_

---

---

## LEPUROSHI

Deshi lepuroshi  
t'bënte një mrekulli:  
të vishej me tesha  
po sikur njeri.

Veshi pantallona,  
këpucë e jelek,  
n'Zvicër porositi  
sahat me qostek.

Mirëpo të ngratit  
i shkoi puna huq,  
sepse veshët e gjatë  
s'i ndenjën n'kapuç.

Rexhap HOXHA



### *Fjalorth*

**qostek** – zinxhir i orës së xhepit  
**kapuç** - kapele  
**i shkoi puna huq** – i shkoi mundi kot

## Bisedojmë pér vjershën

Kjo éshtë një nga vjershat më të bukura të shkrimtarit tonë të njohur pér fëmijë, Rexhep Hoxha. Pas leximit, domosdo shkakton një gaz të lehtë te lexuesi, një kënaqësi.

A e keni edhe ju këtë ndjenjë? Nëse po, a thua pérse?

### Detyrë

Shkruajeni përbajtjen e kësaj vjershe.

### Luajmë dhe këndoymë:



#### Po nget lep'ri

Po nget lep'ri hop, hop  
I rreh zemra kllop, kllop, kllop  
Tue thirr ésht' hej, hej, hej  
Ujku unshëm u, u, u,



### Shpjegim:

Lepurin e luan një vajzë, ndërsa ujkun një djalë. Fëmijët, në rrëth, qëndrojnë në këmbë. Djali që paraqet ujkun gjendet jashtë rrëthit, kurse vajza që luan lepurin éshtë brenda rrëthit.

Tërë ngjarja zhvillohet me shpjegimin nga ana e mësueses pér shtazët e egra. Fëmijët, në këmbë, paraqesin drunjët në pyll.

Lepuri me dy gishta të duarve të ngritur, që i mban mbi kokë, ligjëron duke kërcyer HOP, HOP, HOP. Tekstin e ligjërojnë edhe fëmijët e tjerë, kurse Ujku, me duar në gojë, ulërin U, U, U.

Në mbarim të gjithë fëmijët kapen dorë pér dore, ndërsa ujku fillon ta ndjekë lepurin, duke depërtuar nëpërmjet fëmijëve derisa e zë atë.


S. Spahiu  
S. Gjinolli

The musical notation is presented on a single staff with a 4/4 time signature. The lyrics are written below the notes, corresponding to the rhythm. The first line of lyrics is "Po nget le - p'ri hop, hop, hop". The second line is "i rreh ze - mra kllop, kllop, kllop". The third line is "tu - e thirr' ésht' hej, hej, hej". The fourth line is "uj - ku un - shem u, u, u". The notation uses various note heads (solid black dots, open circles, vertical dashes) and rests (vertical lines with a diagonal slash). The staff ends with a double bar line and repeat dots.

## BLEGA, DEGA DHE SHEGA

- Përkulu pakëz, moj degë!
  - Ç'do, vashëzo?
  - Ta këpus një kokërr shegë.
  - Çka do t'i bësh?
  - Ku do ta lësh?
  - Do ta vë në vitrinë...
  - Ehe! E pse?
  - T'ia shijoj bukurinë.
  - Vetëm aq?
  - Paj...
  - S'më kënaq.
  - Mund ta fus në vizatim...
  - Sa mirë!
  - ... dhe t'ia fal gjyshit tim.
  - Tjetër? E pastaj?  
Dale... pastaj.... pastaj...
  - Të kalbet zemra e saj?!
  - Ah, jo! Do ta ndaj pjesë-pjesë...
  - Për vete?! Ç'e gjete?!
  - ... me vëlla e motër, për besë!
  - Ashtu! Zgjate dorën, moj Blegë...
  - E zgjata...
  - ... dhe këpüte një kokërr shegë.
- Dhe u përkul dega te Blega. Në dorë i kuqëloj shega.

Arif DEMOLLI



### *Fjalorth*

shegë – pemë bregdetare

### **Bisedojmë për tregimin**

Ky është një tregim i shkurtër për bisedën e Blegës me shegën.

Për çka bisedojnë ato?

Çfarë i kërkon Blega shegës?

Kur përkulet dega te Blega dhe çfarë ia mbush mendjen të bëjë këtë?

### **Detyrë**

Bëhuni dikush shegë, dikush degë e dikush Blega dhe luajeni këtë tregim në klasë.





## VITI I RI

I bardhë nëpër borë  
Viti i Ri vjen,  
mbushur e ka këngën  
plot me dashuri,

por askënd në botë  
nuk e kapërcen,  
pa u ndalur pakëz  
në zemrën e tij.

Botën tonë atëherë  
e përshkojnë urimet  
dhe na duket toka  
si një balerinë,

e viti i vjetër  
na i mbledh kujtimet,  
e shtigjeve t'kohës  
qëndis historinë!

Agim DEVA

### *Fjalorth*

shtigje - vende të hapura në gardhe apo udhë të ngushta në pyll

### **Bisedojmë për vjershën**

Në këtë poezi përshkruhet si vjen Viti i Ri. Me çka e ka të mbushur këngën ai? Bashkë me mësuesin/sen shpjegoni çka do të thonë vargjet:  
*Askënd në botë / nuk e kapërcen? Po vargjet: Viti i vjetër / na i mbledh kujtimet?*

### **Pyetje**

Në cilën datë bie festa e Vitit të Ri?

Si e festoni ju atë?

A i gëzoheni festës së Vitit të Ri dhe pse?


Ku keni më shumë dëshirë të jeni për festën e Vitit të Ri, këtu ku jetoni apo në vendlindjen e prindërve tuaj?

### **Detyrë**

- Mësojeni vjershën përmendsh, që ta recitoni para prindërve ose edhe në shkollë.
- Shënoni në fletore edhe disa festa që festohen në familjen dhe në mjedisin tuaj.

### **Këndojmë**

## **Urime Vitit të Ri**



Allegretto

Ja na er - dhi vit - i ri sa gë - zim o fë - mij',

V. Filaj

Do t'na sjell' plot dhu - ra - ta lo - dra, li - bra ço - ko - la - ta

Ref.

të kér - cejm' të kén - dojm' mir' se er - dhe të u - rojm'.





## MBRETI DHE BUBURRECI

E pyeti mbreti buburrecin:

- Sa bukë ha ti për një vit?
  - Një kokërr grurë, - u përgjigj buburreci.
- Atëherë mbreti mori një shishe, e futi aty një kokërr grurë dhe e mbylli buburrecin në shishe.
- Pas një viti e çeli shishen. Pa se në krye të një motmoti buburreci e kishte ngrënë vetëm gjysmën e kokrrës. Atëherë mbreti e pyeti:
- Pse na the se për një vit ti e ha vetëm një kokërr grurë? Ç'u bë që e paske ngrënë vetëm gjysmën e saj?
  - U tremba që nuk do të ma hapni grykën e shishes në krye të vitit.
- E ruajta gjysmën tjetër për ta mbajtur gjallë shpirtin, - u përgjigj buburreci.

Përrallëz shqiptare

*Fjalorth*  
**motmoti – viti**

**Bisedojmë pér përrallëzën**

Përse buburreci i kishte ndërruar fjalët gjatë kohës sa kishte qëndruar i mbyllur në shishe?

Përse e kishte ngrënë vetëm gjysmën e kokrrës së grurit?  
Çka do të ndodhte sikur buburreci ta kishte ngrënë krejt kokrrën e grurit  
dhe mbreti të mos e kishte hapur shishen?

**Detyrë**

Mëso ta ritregosh këtë përrallëz.

**Fjalë të urta**

Aj qi s'kursen, nuk vlen.

Pika-pika bëhet lumi.

Merre vrapi, sa ke hapin.

## Luajmë dhe këndojojmë:

### Mor buburrec

Mor' babbrrec, mor' babbrrec,  
Ti gjith ditën ec e ec;  
Mblidh e mblidh e grumbullo  
Pa më thuaj pse punon?

Mor' babbrrec, po fryn murlan,  
Një barrë grurë ma jep hua,  
Se t'a laj porsa t'vij' vera -  
Për një barrë t'jap dy të tjera.



### L. Deda

Musical notation for the song 'Mor buburrec'. The music is in common time (indicated by '4'). The lyrics are written below the notes. The first line ends with a bracket labeled '1' under 'të' and '2' under 'ec'. The second line ends with a bracket labeled '1' under 'e' and '2' under 'non'.

Mor' bub - rrec, mor' bub - rrec      ti gjith' di - tën ec e ec  
mblidh e mblidh e grum - bu - llon pa më thu - aj pse pu - non pse pu - non



## SHKOLLA IME

E bukur si hëna,  
e dashur si nëna,  
e pastër si burimi  
edhe si zog gjëzimi  
është shkolla ime,  
është shkolla ime!

E ndritur si dielli,  
e lartë si qielli,  
e fortë si trimi,  
e bardhë si agimi  
është shkolla ime.  
është shkolla ime.



*Mehmedali HOXHA*

### Bisedojmë për vjershën

Në këtë vjershë autori bën fjalë për shkollën.  
Me çka e krahason poeti shkollën?  
A e përjeton edhe ti kështu shkollën tënde?

### Mësojmë më shumë

Krahasimi me gjërat dhe fenomenet që i bëhet shkollës, vjershën e bëjnë  
dhe më të bukur. Pra poeti këtu përdor një figurë të bukur letrare që  
quhet *krahasim*, e cila përdoret dendur në të shprehurit poetik.

### Detyrë

Diskuto apo shkruaj:  
Çka të pëlqen në shkollën ku ndjek mësimet.

Mësoje vjershën përmendsh.  
Përpiku edhe ti të shkruash një vjershë për shkollën tënde!

## FUSTANI I ZANËS

Ky fustan i Zanës,  
i kaltër, i lehtë,  
sikur e ka qepur  
me një metër det.

Kur era e malit  
i vishet ngadalë,  
zbresin nga fustani  
fushës qindra valë.

Lulet gushëbardha,  
ngjitur pas pëlhirës,  
duken si zambakët  
në liqenet e Lurës.

Shkëlzen ZALLI



### Bisedojmë për vjershën

Pse thotë poeti se Zana sikur e ka qepur fustanin me një metër det?  
Ku ndodhen liqenet e Lurës?

### Detyrë

Mësoje vjershën përmendsh.

Vizato Zanën me fustan me lule, sipas përshkrimit në këtë vjershë!



## ÇUPA QË DERDHTE TRËNDAFILA NGA GOJA

Djali i një mbreti donte të martohej. Si mësoi se një plakë kishte një çupë fort të bukur, shkoi ta shihte. Kudo që shkelte çupa, dilte bar; kur qeshte, nga goja derdhë trëndafila; kur qante, nga sytë i rridhnin margaritarë. Princit çupa i pëlqeu fort.

U kthye në shtëpi dhe i tha t'et:

- Atë çupë do ta marr grua.
- Merre, po të pëlqeu, o bir, - i tha i ati.

Mbreti i çoi fjalë plakës:

- Çoma çupën bashkë me një shërbëtore. Dua ta marr nuse për djalin.

Gjatë udhës shërbëtorja i tha vajzës:

- M'i jep pak rrobat e tua të shoh si më rrinë... Do të t'i kthej pas pak.

Çupa ia dha rrobat e bukura. Shërbëtorja e hodhi çupën në një gropë. Pastaj shkoi te biri i mbretit.

Djali i mbretit u habit. As mbinte bar nën këmbët e nuses së tij. As i dilnin trëndafila kur qeshte. As i rridhnin margaritarë kur qante.

Në gropën ku ra çupa mbiu bar. Një shërbëtore e mbretit i conte atje patat për të kullotur. Kur i pa mbreti patat aq të majmura, pyeti:

- Ku po i kullot patat që janë majmur kaq shumë?
- Në një lëndinë të njomë, - u përgjigj shërbëtorja.
- Ç'është ajo lëndinë në midis të dimrit? – u habit mbreti.

Dhe shërbëtorja i tregoi fill e për pe ç'i kishte ndodhur çupës së plakës.

- Ti di si të ma sjellësh këtu, - i tha shërbëtores.

Kur çupa erdhi në pallat, mbreti e pa se kudo që shkelte ajo mbinte bar. E bëri të qeshte dhe nga goja i dolën trëndafila. E bëri të qante dhe nga sytë i rrodhën margaritarë.

Në pallat u bë dasmë e re për nusen e vërtetë. Të gjithë ishin të lumtur, përveç shërbëtores mashtruese; atë e përzunë nga pallati.

Përrallë shqiptare

### *Fjalorth*

shërbëtore – vajzë e varfër që kryen punë te të pasurit.

margaritarë – gurë të çmueshëm

i tregoi fill e për pe – i tregoi gjithë ngjarjen që nga fillimi e deri në mbarim

### **Bisedojmë për përrallën**

Përse djali i mbretit vendosi të merrte për grua bijën e plakës?

Çka bëri mbreti kur dëgjoi për dëshirën e të birit?

Çka i ndodhi çupës gjatë rrugës që e bëri bashkë me shërbëtoren?

Si e vërejti mbreti se ajo nuk ishte çupa për të cilën ishte folur?

Kush ia tregoi mbretit historinë e çupës që e kishte kërkuar për nuse të djalit?

Çka urdhëroi mbreti kur mori vesh atë histori?

Çka ndodhi kur çupa erdhi në pallat?

Çka u bë me shërbëtoren mashtruese?

### **Detyrë**

Ritregoje përrallën sipas pyetjeve të bëra?


Shkruaj me një fjali se cili është mësimi që marrim nga kjo përrallë.

## FESTA JOTE – FESTA IME

Mamin për Tetë Mars  
fort e putha unë  
dhe në vesh i thashë:  
“Qofsh e lumtur shumë!

Kur ti je e lumtur,  
ndiej dhe unë gëzime:  
„Festa jote e bukur  
është dhe festa ime!”

Adelina MAMAQI




Abdurrahim Buza:  
*Vajza me kordele*

### Bisedojmë për vjershën

Festa e nënës është një ditë e gëzuar. Për nënën del urimi më i mirë, ndaj me të drejtë thuhet në këtë vjershë: “Festa jote e bukur / është dhe festa ime!” Por përse është kështu? Përpiquni të përgjigjeni në grupe dhe paraqitni së bashku përgjigjet.

### Detyrë

Provo të shkruash një vjershë apo një urim për nënën.



## GOMARI DHE UJKU

Një herë ujku vajti në lëndinë dhe gjeti një gomar duke kullotur. Iu soll gomarit rreth e rrrotull dhe deshi ta hante.

Gomari e ndjeu veten ngushtë.

- Aman, - i tha ujkut, - mos më ha, se do të të gjej mish shumë të mirë. Unë di një tufë delesh të majme dhe po të çoj atje që të hash dhe të ngopesh.

Ujku u mendua. Goja i rroddhi lëng.

- Mirë pra, - i tha gomarit. – Ulu të të hip në kurriz, se jam lodhur e jam munduar shumë derisa erdha këtu.

Gomari u ul dhe ujku i hip i kurriz si efendi.

E kështu, dalëngadalë, u nisën nëpër ara drejt e në fshat. Atë çast, një qen e diktoi ujkun dhe nisi të lehte: ham-hum!... Pas tij filluan të lehnin edhe të tjerët.

Ujku e ndjeu rrezikun. U hodh në tokë dhe ia mbathi me të katra në pyll. Kur arriti në pyll dhe pa që ndodhej larg rrezikut, tha më vete:

- Babai në këmbë më ka ecur. Edhe gjyshi në këmbë. Po mua ç'mu desh t'i hipja gomarit në kurriz?

Bedri DEDJA

### *Fjalorth*

vajti – shkoi

aman – tē lutem

goja i rrodhi lëng – lakmoi

efendi – titull i lartē turk

### **Bisedojmë pér përrallën**

Çka i tha gomari ujkut, kur pa se kishte rënë nē kurthin e tij?

Po ujku çfarë tha?

Çka bën ujku kur ndien t'i ofrohen qentë duke lehur?

Çka tha vetëmevete ujku kur u largua nga rreziku?

Kush kë e ka mashtruar nē këtë përrallë?

### **Detyrë**

Mësoni ta ritregoni këtë përrallëz.

Bëni një vizatim pér këtë përrallëz.

## ERDH' BABAI NGA KURBETI

Erdh' babai  
nga kurbeti;  
nëna poqi  
një gjeldeti.

Po babi  
s'hëngri fare;  
rrinte, qante  
në dritare.

Lutu unë,  
lutu motra;  
më në fund  
u ul te sofra.

- Nuk qaj më, -  
tha i dredhur, -  
është hidhërimi  
që kam mbledhur.

Sa të zbrazet  
zemra ime,  
të ketë vend  
për gëzime.

Këndon gjyshi  
lehtë-lehtë.  
U bë babai  
me fletë.



Gaqo BUSHAKA

## Këndojmë këngën popullore:



Allegretto



Kush i pa - ri ba - ni mo - re djal' gyr - be - tin mos ia dhasht'a -



## Fjalorth

**kurbet** – mërgim, të qenët larg atdheut

**sofër** - treyzë e rrumbullakët, ku shtrohej buka

**me fletë** – këtu: i gëzuar

## Bisedojmë për poezinë

Përse babi rri në dritare dhe qan?

Kur babai bëhet i lumtur?

## Detyrë

Diskutoni pse kanë ardhur prindërit apo gjyshërit tuaj këtu ku jetoni tash?



## GURI I SKËNDERBEUT

Një ditë Skënderbeu porositi mjeshtër Medarin t'i farkëtonte një shpatë të re. Pas një javë, Gjergj Kastrioti shkoi te farkëtari.

- Puna e mbarë, mjeshtër! Erdha të marr shpatën që kam porositur. E keni gati? – pyeti Skënderbeu.
- Po, shpata pret të zotin. Kurrë në jetën time nuk kam farkëtuar shpatë kaq të madhe e të rëndë, - i tha farkëtari.
- Unë dua të di se sa e fortë është, - tha Skënderbeu. – Tash do ta provojmë. Eja me mua!

Skënderbeu doli nga farka me shpatën në dorë. Pas tij doli edhe mjeshtër Medari, si edhe njerëzit që e shoqëronin.

Jashtë farkës qe një shkëmb sa një qerre. Skënderbeu hipi në kalë dhe filloi ta godiste shkëmbin me shpatë. Pastaj, shikoi tehun e saj mos i qe bërë ndonjë dhëmb. Shpata ishte po aq e mprehtë si edhe më parë. Skënderbeu i tha Medarit:

- Të lumtë, mjeshtër! Se shpata s'më duhet si stoli, po për të luftuar. Skënderbeu shpërblye mjeshtrin, ngjeshi shpatën në brez dhe iku i gjëzuar. Që atë ditë, shkëmbit ku provoi shpatën Skënderbeu i thonë "Guri i Prerë" ose "Guri i Skënderbeut".

Naum PRIFTI

### *Fjalorth*

farkë – vendi ku punon farkëtari

farkëtar – ai që punon në farkë

stoli – send zburimi

### Bisedojmë për tregimin

Kush ishte Skënderbeu?

Si e quanin ndryshe atë?

Përse ai kishte dy emra?

Çka e porositi Skënderbeu mjeshtër Medarin?


Çfarë shpate i kishte farkëtuar mjeshtër Medari Skënderbeut?

Çka i tha Skënderbeu mjeshtrit Medar, pasi e provoi shpatën në shkëmb?

Si quhet sot guri në të cilin Skënderbeu e provoi shpatën e tij?

### Detyrë

Me mësuesen/in dhe me prindërit bisedoni më shumë për Skënderbeun.



## ZOGU CICËRON...

Zogu cicëron: "Mirë se erdhe!"  
Në thurimën që i thonë çerdhe.

Ketri të përshëndet me ngrohtësi  
Te dera e strofullit të tij.

Ta bën be-be-be delja e bardhë  
Nga vatha e rrëthuar me gardh.

Mu-mu-muu! – të pret në stallë  
Një lopë me gojën plot tallë.

Një qen i racës së mirë  
Rri në stelë, në zinxhirë.

Ki-ki-ri-ku! – gjeli thërret  
Nga majë e koteçit të vet.



Bilbil, papagall, kanarinë...  
Ndodh ta kenë fat kuvlinë.



Arusha gjumin e thellë  
E kalon në ndonjë shpellë.

Diku ndonjë hallemadh  
Ngre kasollen në livadh.

Indianin pranë lumi  
Veç n'tendë e zë gjumi.



Eskimezi në Veri  
Në iglo gjen qetësi.

E një malësor me llullë  
Pret mysafirët në kullë.

Miku im Xim, mikja Shpresë  
Jetojnë në një banesë.



Një Yll apo një Anilë  
Verën e kalon në vilë.

Mbreti e ka atë fat  
Të jetojë në pallat.

Dhe secili, pa mahi,  
Thotë: "S'ka si kjo shtëpi."

Arif DEMOLLI

### *Fjalorth*

**thurimë** - diçka që thuret

**tallë** – ushqim për kafshë nga kërcejtë e misrit

**iglo** – shtëpi bore eskimezësh

### **Bisedojmë**

Secila qenie ka një strehë të veten ku jeton. Ato kanë emra të ndryshëm. Njerëzit rëndom jetojnë nëpër shtëpi, banesa e dikush edhe në ndonjë kasolle etj. Po qeniet e tjera ku jetojnë?

### **Pyetje**

Cilat vende i shfrytëzon njeriu për banim, sipas këtyre vargjeve?

Si quhet vendi ku jeton ti?

Ku do të jetoje ti më me dëshirë?

### **Detyrë**

Vizato tri nga objektet e banimit që përmenden në këto vargje.

### **Këndojojmë: Gjuha e kafshëve**

K. Mullai

Ciu, ciu, ciu, o zog i vo gël ciu, ciu, ciu, ciu qan a po kën don ciu, ciu, ciu,  
 ciu, ciu flas me në-nën ti me ciu, ciu a jo gju-hën ma kup ton ciu, ciu, ciu



## MUNGESA NË MËSIM

Pjesë skenike

Luajnë:

BUFI, nxënës

KETA, shoqe e klasës

BUFI (*i cili ka munguar në mësim numëron me gishta*), Më ka shënuar, s'më ka shënuar, më ka shënuar, s'më ka shënuar, më ka shënuar, s'më ka shënuar.... s'më ka shënuar...

BUFI (*Ketës, sapo e sheh në derë*), Hë?!...

KETA (*E lodhur nga vrapimi*) : Sot kishim vetëm tri orë...

BUFI: E ora e katërt?

KETA: Ora e katërt vizatim. Temë e lirë, por mësuesja na lëshoi. Na tha t'i vazhdojmë punimet në shtëpi...

BUFI: Vizatim? Temë e lirë...?!

KETA: E ti as sot nuk erdhe në shkollë...

BUFI: (*Duke dashur të arsyetohet*): Po...

KETA: Mësuesja pyeti për ty...

BUFI: Po ti çka i the?!...

KETA: E gënjeva, i thashë se je i sëmurë...

BUFI: Ani de, mirë i paske thënë.

KETA: Ama ti s'ke qenë i sëmurë, apo jo?!

BUFI: Aiii, edhe ti... Mos pyet shumë... Ndoshta kam qenë...

Pjesë nga drama për fëmijë "Gogoli"  
Arian KRASNIQI

### **Bisedojmë për tekstin**

Bufi dhe Keta janë në një klasë. Por, derisa Keta është e rregullt në mësime, Bufi ka zënë të bëjë mungesa. Këtu kemi bisedën e tyre për mungesën e Bufit në shkollë. Çfarë mendoni, a është i qartë arsyetimi i Bufit për mungesën e tij në mësime?

### **Mësojmë më shumë**

Biseda e këtyre nxënësve midis tyre quhet *dialog*.  
Dialogu përdoret shumë në teatër dhe në film.

### **Detyrë**

Lozeni këtë pjesë skenike në klasë.





## PEMËT NË VERË

Mollës – të hollës  
iu ka tharë fytì.  
Për një gotë ujë  
dielli e mbyti.

Dardhës – të bardhës  
iu ka tharë dora.  
Nga vapa e verës  
lëngon e gjora.

Kumbulla – sumbulla  
s'mund t'i thotë kuj':  
“Si t'shkoj te lumi  
të pi pakëz ujë?”

I pari – kopshtari  
zgjohet që me natë,  
pemëve të etura  
u jep limonatë...

Vehbi KIKAJ

### *Fjalorth*

**lëngon** - vuan

**sumbull** – lloj kopse rrobash

**kopshtar** – ai që punon kopshtin

**limonatë** – pijë me lëng limoni

### **Bisedojmë për vjershën**

Në këtë vjershë të bukur kemi të paraqitur gjendjen e pemëve në verë, kur ato kanë aq shumë nevojë për ujë. Por kush i shpëton ato nga kjo situatë dhe si e bën ai këtë?

### **Detyrë**

Plotëso tabelën! Majtas shkruaj emrat e disa pemëve dhe perimeve në gjuhën shqipe dhe djathas në gjuhën e vendit ku jeton tash.

## Përrallë

### DY DHITË

Dy dhi, duke kullotur njëherë në një mal të lartë, hasën në një udhë fort të ngushtë. Udhë ishte aq e ngushtë, sa mezi kalonte njëra prej tyre. Po edhe të ktheheshe prapa ishte e pamundur. Nga ana e sipërme e udhës ndodhej një shkrep guri i lartë. Kurse nga ana e poshtme e udhës ndodhej një rrëpirë e thellë.

Ç'thoni ju, si vepruan dy dhitë?

Njëra prej tyre u ul në gjunjë ngadalë, duke u mbështetur mirë pas shkëmbit të gurit. Kurse dhia tjetër kaloi me kujdes mbi kurrizin e shoqes së vet, që rrinte ulur në gjunjë dhe doli në anën tjetër.

Kështu, të dy dhitë shpëtuan dhe morën udhën e vet, duke kullotur gjethë të egra nëpër ato kodra.


Dy dhi të tjera, duke kullotur nëpër disa kodra, u puqën në buzë të një përroi të rrëmbyeshëm. Përmbi atë përrua ndodhej një tra për të kapërcyer matanë ujit.

Dhitë vështruan njëra-tjetrën në sy. Secila prej tyre dëshironte të kalonte para shoqes. Ato qëndruan një copë herë me një këmbë në buzë të pérroit dhe me këmbën tjetër në tra, duke pritur njëra-tjetrën se cila do të lëshonte vendin për të kaluar. Por asnjëra nuk liroi rrugë.

Atëherë u nisën që të dyja deri në mes të traut të ngushtë duke filluar të zihen e të shtyhen me brirë, gjersë rrëshqitën të dyja, ranë në përrua dhe u mbytën në ujë.

Po t'i kishin lëshuar udhë njëra-tjetrës, të dyja do të kishin shpëtuar.

Konstantin KRISTOFORIDHI



### *Fjalorth*

buzë - skaj  
 kurriz - shpinë  
 rrëpirë - vend i pjerrët  
 shkrep - shkëmb i mprehtë  
 tra - dru i madh në kulme të shtëpive  
 u poqën - u takuan

### **Bisedë për përrallën**

Në çfarë vështirësie hasën dhitë?  
 Si vepruan dy dhitë e para?  
 Si vepruan dy dhitë e dyta?  
 Çfarë mësimi marrim nga veprimet e tyre?

### **Detyrë**

Ritregojeni përrallën në fletore

### **Luajmë dhe këndojojmë :**

### **Dy dele (Lojë popullore)**

Dy dele, treqind pare  
 Eja Dreni, eja Dreni, hyr në valle  
 Merre Gentin, merre Gentin dor' për dore,  
 Mashalla, mashalla ç'ju paska hije  
 Si bakllava, si bakllava në teplie.

Popullore

## SHKOPI MAGJIK

Lus magjistarët e botës  
(Nëse duan t'u bëhem mik),  
T'ma falin një shkop magjik.

T'i prek lotët e vogëlushit  
E t'i bëj kokrra të rrushit.  
Frikacakun ta bëj t'fortë,  
Ta prek gurin, ta bëj tortë.

Sa ta prek rrasën e thatë  
Ta bëj vrik çokollatë.  
Sa t'prek guralecë n'hone  
Në çast të bëhen bonbone!

Me këtë shkop si askush,  
Ujkun ta bëj lepurush!  
Murrizin ta kthej n'qershi,  
Kungullin ta bëj shalqi.  
A s'do t'ishte kjo mrekulli?

Rifat KUKAJ



### *Fjalorth*

**guralec** – gur i vogël

**hon** – greminë vend i thellë midis kodrave

**murriz** – dru që bën kokrra të vogla të kuqe

**rrasë** – copë guri e rrafshët

### **Bisedojmë për poezinë**

Çfarë kërkon poeti në fillim të kësaj poezie?

Përse e bën ai këtë lutje?

A të pëlqejnë dëshirat që shfaqen në këtë poezi?

### **Detyrë**

Sikur të kishe një shkop magjik, çka do të bëje me të? Shkruaj!

Ritregoje vjershën me disa fjali në fletore.





## ZEMRA E DIELLIT

- Baba!
  - Urdhëro, Ardi!
  - I kujt është Dielli?
  - I të gjithëve.
  - Ashtu: imi, yti, i atij, i atyre...
  - Dielli është edhe i tërë botës: i Tokës, i Hënës, i yjeve të panumërt, i planetëve dhe i kometave të shumta. Ai ndriçon për të gjithë njësoj.
  - Oh, kjo është mrekulli, baba. Por nuk po e kuptoj si e arrin ai tërë këtë: të ndriçojë mbarë botën dhe t'u takojë të gjithëve?
  - Ai ka zemër të madhe, të ngrohtë, o bir...
  - Me siguri, baba. Por prapë po habitem. Si ndriçon kaq shumë dhe prapë, me gjithatë, nuk harxhohet?
  - Natyra që përtëritet, këngët që derdhen, falënderimet e shumta nga të gjitha anët e botës, i jep vullnet e fuqi. Lumturia që ai ua fal të tjerëve e bën edhe atë të lumtur, i jep ngrohtësi zemrës së tij. Duke i gjuar përherë të tjerët, duke e ngjallur e duke lulëzuar vazhdimisht jetën, ai sikur nuk ka kohë të vjetrohet. Përherë rri i ri, i fortë dhe duket i buzëqeshur...
  - Sa mirë do të ishte sikur të gjithë njerëzit të kishin zemër të ngjashme me Diellin!
  - Kjo do të ishte mrekulli! Atëherë edhe lumturia në botë do të ishte e paskajshme.
- Atë e bir kishin arritur në parkun e qytetit. Dielli sikur e kishte dëgjuar bisedën e tyre. Ua fali një buzëqeshje nga zemra e tij e ngrohtë, e madhe.


Ymer ELSHANI

### Bisedojmë për tregimin

Çka e pyet Ardi babanë?  
Si i përgjigjet babai atij?  
Çfarë thotë babai se si arrin dielli t'i ndriçojë të gjithë njerëzit?  
Po si nuk i shpenzohen ato rreze?  
Dhe ç'dëshirë shfaq Ardi, kur merr vesh për këtë rol kaq të  
rëndësishëm të Diellit?  
Ç'përgjigje i jep babai?

### Detyrë

Merrni dikush rolin e Ardit e dikush atë të babait dhe luajeni  
këtë tregim në klasë.





Hamdi Bardhi:  
*Fasada*

## VENDI IM I SHTRENJTË

I bardhë është vendi im, i bardhë,  
E lumenjtë të shpejtë të argjendtë;  
I kaltër është qielli im, i kaltër,  
E lumenjtë të shpejtë të argjendtë;  
I kthjellët është deti im, i kthjellët,  
E lumenjtë të shpejtë, të argjendtë;  
Hirplotë është vendi im, hirplotë  
Me qiell të kaltër e të kthjellët.

Hivzi SULEJMANI

*Fjalorth*

hirplotë – që është plot bukuri, që ka pamje shumë të bukur

### Bisedojmë për poezinë

Në këtë poezi poeti i këndon vendit të vet, bukurive të tij natyrore, qiellit të tij të kaltër e të kthjellët. Dashuria për vendin është tejet e fuqishme. Këtë e keni parë edhe nga ndjenjat që kanë prindërit tuaj për të. Ata mezi që presin pushimet vjetore të kthehen nëpër ato bukuri, të cilat u joshin edhe juve aq shumë.

Pushime të këndshme!



Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Syla  
**LETËRSI SHQIPTARE**  
**Fletore tematike**

Botimi i parë

Botues:  
*Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë*

Për botuesin:  
*Agim Lluka*

Redaktor teknik:  
*Lavdim Beqiri*

Tirazhi: 5.000 kopje  
Formati: 205x285

U shtyp në shtator 2010  
në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë  
[www.dukagjinigroup.com](http://www.dukagjinigroup.com)

Katalogimi në botim - (CIP)  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

021.18 (076.1) (075.2)

Sheqiri, Rizah

Fletore tematike: letërsi shqiptare (lexime): për nivelin e parë/  
Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Syla. - Botimi 1.-Pejë:  
Dukagjini, 2010. - 60 f. ilustr. me ngjyra; 27 cm.

1. Islamaj, Shefkije

2. Syla, Xhevat

**ISBN: 978-9951-05-234-4**

*Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,  
të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr 294/2, të datës 22.06.2010*